në një mënyrë të arsyeshme dhe të pranuar ndërkombtarisht, për të siguruar aplikimin e këtyre standardeve, projektligji autorizon ministrin e tregtisë dhe industrisë si të vetmën agjensi që do të implementoj masa kufizuese në tregti, lidhur me këtë ministria e tregtisë dhe industrisë obligohet të siguroj që të gjitha masat kufizuese mund të zbatohen në mënyrë të koordinuar dhe efikase.

Qdonjera prej dispozitave të projektligjit pas dekretimit sigurojnë se tregtija e Kosovës me vendet e tjera dhe veqanërisht me vendet e OBT, e të bashkësisë evropiane të jetë e liruar nga kufizimet e panevojshme, projektligji për tregtinë me jashtë është i rëndësishëm së veçantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe si is tillë rekomandojmë të miratohet me miratimin e tij nga Parlamenti i Kosovës, duke filluar me një procedim të rregullt. Nëse doni t'ju them se ligji ka, përbëhet nga 8 kapituj, nga 52 nene na kapitullin e parë përfshihen dispozitat e përgjithshme si rëndom në kapitullin 2 normat themelore të veprimtarisë së tregtisë me jashtë dhe 3 masat e përgjithshme për kufizimin e aktiviteteve të tregtisë me jashtë, dhe 4 mallrat e importuara, dhe nën 5 mallrat e eksportuara, në kapitullin e 6 e drejta për eksport dhe import, në të 7 dispozitat plotësuese dhe në të 8 dispozitat përfundimtare, ju falënderit,

Kryetari Daci, ministër ju falënderit, për hyrje në shqyrtim të parë në debat për një referim përmbajtësor të kuartë prandaj e shpalli të hapur debatin për shqyrtimin e parë të projektligjit për aktivitetin e tregtisë me jashtë. Deputetët e interesuar le të paraqiten në mënyrë që të kemi mundësinë me krijuar radhën, urdhëro Fatmir.

Z. Fatmir Rexhepi,

I nderuar kryetar, zonja dhe zotërinj deputet. Projektligji mbi aktivitetet e tregtisë me jashtë, e kam lexuar me vëmendje, duke e ditur edhe rëndësinë që e ka për biznesin për ekonomi, prandaj vlerësoj se përmbajtja e këtij porojektligji brenda 8 kapitujve dhe 52 neneve është shumë e kuptueshme, e lehtë pragmatike dhe për zbatim është funksionale. Sepse në këtë projektligj d.m.th, ka parimet themelore siq është tregtija e lirë, konkurrenca por edhe mbrsojta e prodhimeve vendore në bazë të atyre përleshkrimeve që janë bërë atje në kuadër të projektligjit.

Projektligjin e mbështes në parim me arsye se i mbulon të gjitha fushat e tregtisë, biznesit, regulativat lidhur me kontratat, sanksionet, lëvizjen e mallrave, pasurisë etj. Por edhe përcakton ashtu siq u tha edhe nga ministri rregullativën normat dhe kushtet me të gjitha standardet teknike të cilat janë pjesë e këtij Projektligji të cilat janë shumë funksionale për zbatim në ekonominë e Kosovës. Në projektligj poashtu është dhe mundësia e implementimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka rëndësi d.m.th të posaçme për bizneset në këtë aktivitet, ligji poashtu është i përshtatshëm me standardet dhe konform asaj qka paraqiti ministri, me vendet tjera të cilat drejtëpërdrejtë do të ndikojnë në aktivitetet dhe investimet të sektorit të ekonomisë në Kosovë, ligji do të forcojë pozicionin e biznesve kosovare në bashkëpunim me institucionet ekonomike në integrimin e tyre me ndërmarrje d.m.th. ekonomike jashtë Kosovës. Prandaj unë si

deputet, ky ligj është i domosdoshëm me prioritet dhe mendoj që do ta marrë vizën e këtij Kuvendi, ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit, z. Dragisha Kerstoviq, pastaj deputeti Berat Luzha dhe deputet Haki Shatri, edhe pse Hakiu ka lypë shumë më heret, por do ta bëj një renditje që të kenë të gjitha grupet parlamentare.

G. Dragiša Krstović,

G. presedniče, gospodo ministri, g. Poslanici jaču samo kratko da se na celishodnost donošenja ovog Zakona, u stvari da se samo na tri aspekta ovog Zakona, prvo ovo je koliko se ja sečam 5 zakon u proceduri u Skupštini, ja barem do sada nisam primetio da je bilo koji serbski ekspert ili serbski stručnjak uključen kod izrade projekta bilo kojeg zakona, ovde je uključen dr. S. Merovci, Azem Hajdari, Muja Donbalaj, Muhamet Jusufi, Neđat Pula i 2 internacionalca. Mislim da bi Vlada i ministarstva nadležna morali ili bilo bi dobro da u buduće o tome da povede računa i da pokušaju da ukljuću nekog od serbskih eksperata kada su pitanja izrada zakonskih projekata, mislim da se time postiči nekakav kvalitet u izradi projekata, ali u svakom slučaju ima to jednu političku dimenziju i mislim da je zbog toga te političke dimenzije bilo bi dobro da i jedan ili dva serbska stručnjaka budu uključeni u ove timove kada se prave nacerti zakona. Ja nemogu ovom prilikom da izrazim kakav će efekt ovaj zakon da ima u Kosovsku privredu, videćemo to u koliko bude zakon usvojen ali želim da skrenem pažnju na jednu stvar, mislim da bar do sada treba izbegavati definicije kao što je definicija u članu 2 u deo gde se objašnjava pojam strane države, to će biti nešto što će da bude prilikom razmatranja ovog zakonskog projekta i neverujem da ćemo se bar kolicija povratak složiti da možemo da prihvatimo takvu jednu definiciju gde strana država da će označavati bilo koju državu i neodvojenu carinsku granicu koja se nalazi van teritorija Kosova. Ovo mislim da prejudicira jedno pitanje koja će biti rešavana ali za sada računamo da možemo da naddemo bolji izraz i da možemo oko toga ta stignemo kompromis, i treća stvar koju želim da kažem jeste da komiteti i poslaničke grupe kada budu razmatrale ovaj projekat zakona trebalo bi da obrate pažnju na odulak tri i mislim da je odeljak 4 na pitanju odnosno odulak 3 da se slućanje ne desi da će ova Skupština raspravljati o nećemu što su ovog trenutka rezervisana ovlašćenja za specijalnog izaslanika generalnog sekretara kad je u pitanju kontrola uvoza i izvoza, mislim da u ustavnom okviru to je jasno zapisano i o tome zaista treba voditi računa, doneti ispravan zaključak, fala lepo toliko.

Kryetari Daci, ju falënderit, Berat Luzha

Z. Berat Luzha,

Të nderuar deputet, mendoj se ky ligj është mjaft i kompletuar dhe përmban të gjitha rregulativat, organizimin e tregtisë me jasht, prandej e përkrahim në parim dhe e mbështesim, këtu janë disa vërejtje, mendoj të natrës teknike që nuk janë përmbajtësore të hiqet neni 50 ku bën fjalë për ligjin aplikativ, pastaj të riformulohet neni 52 dhe të

riformulohet se ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi , nënshkruhet nga kryetari i Kuvendit dhe shpallet te SHPK-ja , gjithashtu edhe neni 51 është mjet i konkretizuar dhe mendoj se duhet të riformulohet , ju falënderit.

Kryetari Daci, jap fjalën z. Haki Shatri, pastaj deputeti Gani Prekopuca , Ssylejman Qerkezi .

Z. Haki Shatri,

I nderuar z. Kryetar, të nderuar deputet, dola këtu që të përkrah propozimin për dhënies në procedurë të mëtejshme të këtij projektligji dhe që të them se pajtohna me sikutimin e z. Fatmir Rexhepit me vlersimet pozitive për këtë drafligj, por duha të them që këtë përkrahje timen e kisha kushtëzuar paraprakisht me një punë që ishte dasht të bëhet në periudhën e shqyrtimit procedura deri te leximi i dytë i këtij projektligji, vërejtjet e mija parimore në këtë projektligj që mendoj se duhet të bëhen deri në shqyrtimiin përfunbdimtar janë këto; qëllimi i nxjerrjes së ligjit nuk është dhën i plotë në at mas sa u dha këtu në diskutimin që bani z. Ministër me prezentimin e këltij ligji, mendoj se duhet të plotësohet , sepse këtu është dhënë vetëm qëllimi është vetëm harmonizimi me aktet normative të bashkësisë evropiane në propozim lilgj kurse në fjalën e hyrjes kuptimi është dhën i plotë. Disa dispozita të këtij Ligji kan karakter sjegues jo të lilgjit p.sh. neni 3.2 , neni 12 etj. Pastaj disa dispozita janë edhe pa kuptim të paktën në shqip, për mu p.sh ka qen nenbi 4 - 1b, 4 - 2 etj. Shumica e dispozitave të këtij ligji kan njëfar parashenje negative d.m.th. ma shumë merret me ate se çka ndalohet mekët ligj se sa me ate se çka srregullohet me kët ligj.

Veprimi që e përshkon këtë ligj jipet përshtypja se nuk stimulohet fort tregtija e lirë, gjegjesisht nuk liberalizohen marrëdhëniet me botën e jashtme në aspektin e tregtisë, te neni 5 pak si tepër centralizohet roli i ministrisë së tregtisë dhe industrisë në këtë fushë, te pjesa aty ku përshkruhet leja për eksport dhe import nuk jipet kurfar alternative në qoftë se refuzohet dhënia e lejes çka do të bëjë kërkuesi i lejes dhe në fund pajtohem me vërejtjet që i dha udhëheqësi i grupit parlamentar të Partisë Demokratike. Në të tri propozimligjet, sikur propozuesi ka harruar se egziston Kuvendi dhe thot ky ligj hyn në fuqi ditën qe e proklamon përfaqësuesi special i sekretarit të KB, ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit z. Shatri, fjalën e ka Gani Prekopuca,

Z. Gani Prekopuca,

I nderuar kryetar, të nderuar deputet, zonja dhe zotërinj ne ndegjuam fjalën e ministrit i cili e dha arsyetimin për këtë projektligj i cili kujtoj se arsyetimi ishte i plotëfuqishëm , kuptimplotë, por dua të them që një start jam në takord me përfaqësuesin e kualicionit serb që tha se duhet të kyqen edhe ekspertë pavarisht nga cili nacionalitet janë.

Ligji që në start kam vërejtje nëse dëshirojmë që të bijmë një ligj është mirë të jetë ligj i qëndrueshëm plr kohëln dhe momentin të cilit i dedikohet , ligji për aktivitetet me

tregtin me jasht , unë e kptoj edhe përkthimin nga anglishtja por nuk mund ta kuptoj përkthimin i cili nuk ka të bëjë me drejtësinë edhe tenton të futet në ligj konkretisht gjithkund në botë quhet ligji i afarizmit me tregtinë ose ligji afarist i tregtisë së jashtme , jo me jasht, aktivitetet janë marrë prej anglishtes, a mund të na thot dikush se çka janë aktivitetet , në mënyrë decidive të përshkruara cilat aktsdivitete cilat punë afariste duhet të kryhen me këtë ligj, jo aktiviteti, jam për ata që të quhet ligji për tregti të jashtme e jo ligji për tregti me jasht ose ligji afarist i tregtisë së jashtme gjithkund në botë edhe në praktik edhe në teori bëhet kështu, mandej kam vërejtje thash se është përkthyer nga anglishtja pa ju përshtat materjes në fjalë , prandaj në shumicën e rasteve është edhe i pakuptimtë , ju lutem merrni lexoni shqip edhe ata që nuk kanë lidhje me tregti të jashtme kanë probleme me formulimin e tillë, edhe një projektligj i tillë na vjen këtu në shqyrtim.

E kam lexuar me vëmendje, është bërë enklavizimi i territorit të Kosovës për tregti të jashtme kur them këtë kam arsyetimin se territori i Kosovës është edhe ashtu i vogël, prandaj edhe do të jetë i pakuptimt, punoj me tregti të jashtme me ekipin tem qe 30 vite kërkun nuk ka që një pjesë e ligjit të vlejë për një komunë e për tjetrën të mos vlejë. Ky ligj duhet ta përfshinë territorin e caktuar , ndash thuaj shtetin, ndash Kosovën vlen për të gjithë, nuk mundet një njësi territoriale e vogël sadoqoftë ta përdor ligjin e tjetri të mos e përdorë ky është gjeneral për të gjithë prandaj po them është bërë enklavizimi i territorit të Kosovës, ligji është shumë voluminoz i cili e byrokratizon tejmas këtë veprimtari ju lutem merrni materjet e lligjeve që i kanë shtetet përreth, pastaj çka të zbulojmë, janë të përkryera, por duhet ti përshtatet kushteve dhe rrethanave të Kosovës, dhe skemi çka të zbulojmë shumë mirë e tha një ditë një profesor i nderuar, shyqur që shqiptarëve s'ju ka mbet me zbulu diçka të re , janë të zbuluara të gjitha por duhet ti praktikojmë në rrethana tona , edhe ti përkthejmë ashtu siq duhet përkthyer dhe ta participojmë një ligj çfare duhet, konsideroj se kjo materje duhet të kodizohet, e jo të sjellen ligje artikulare të papërfunduara dhe kjo kujtoj është simulim i punës së Kuvendit. Për arsye se OBT për tregti të jashtme nuk preferon enklavizimin e territorit të Kosovës, OBT për tregti të jashtme nuk sjell që të quhet aqktivitet i tregtisë, prandaj nuk kam nevoj me u zie me këto sende , ju lutem të konsultohen edhe njerëzit që mirren me këtë lami, ligji është e vërtet që tani po synon një sistem të tregtisë së lirë nuk ka kode, nuk ka kuota nuk ka lilej devizorë , por gjithkund në botë merrni shiqoni ligji për tregti të jashtme shkon me procesin doganor , rregullat doganore janë bashkarisht, çdokund e ke mund të jetë lilej doganor, rregullat e lilejit doganor enkas ma vonë të vijnë pas ligjit për tregti të jashtme, prandaj po them edhe njëhere është mirë që këto gjëra që në start të eliminohen , unë nuk po hyj andej kush i ka bërë këto ligje , praktika do ti tregon, por kërkund nuk përmendet tregtija kufitare e lirë, kërkund nuk përmenden zonat kufitare , zonat doganore, zonat që neva na duhen , prandaj po them edhe një here është mirë që barem deri dikund me ligjet tjera të avansuara të koordinohet në atë drejtim unë e di profesori i nderuar z. Ministër e ka një libër për klasën e parë të ekonomisë për bazat e tregtisë jamë 1 milion për qind i sigurt se sikur të ishte konsultuar ai me ato elemente që i ka do të ishte dalë një ligj shumë më i mirë, ju falënderit,

Kryetari Daci, ju falënderit, fjalën e ka Sylejman Qerkezi, bëhet gti Sebahate Grajqevci,

Z. Sylejman Qerkezi,

Kryesi e nderuar , z. Deputet unë do hedh një vështrim në shiqim të parë duke jashtëzakonisht i thjeshtë meqë jemi drejt rrugës së shtetësisë së Kosovës, mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm në veçanti ndaj ligjeve të tilla kur kemi të bëjmë me marrëdhëniet ndërshtetërore , mendoj se detyrimisht duhet të përmendet emri Kosovë, pavarësisht se ajo nënkuptohet , pra mendoj se projektligji për aktivitete e tregtisë me jashtë , detyrimisht të futet emri Kosovë, aktivitetet e tregtisë së Kosovës me jashtë. Falënderit.

Kryetari Daci,ju falënderit ,Z. Grajqevci,le të përgaditetet deputeti Bajrush Xhemajli.

Z. Sebahate Grajqevci,

Të nderuar të pranishëm ju përshëndes, ligjin e kam lexuar me vëmendje dhe vërejtja kryesore është se përkthimi është i dobët, do të thoja se shpesh më është dashtë ta lexoj versionin anglisht për ta kuptuar qart përmbajtjen e këtij Ligji, në parim këtë ligj e përkrahim , vërejtje konkrete kam . p.sh. në kapitullin 2 të përmirësohet titulli dhe të shkruhet Normat themelore të veprimtarisë së tregtisë së jashtme, pastaj është neni 4 rreshti i 2 ku fjalisë Qeverisë do të, konsideroj se duhet të futet në kllapa ose mundet kur është e nevojshme. Fjalja vazhdon. Pastaj neni 8 është tepër i paqartë dhe mendoj se duhet të korrigjohet , Neni 16 pika J të shtohet në fund të këtij neni të shtohet atyre që prodhojnë dhe të atyre që prodhohen në Kosovë,. këtu është fjala për mallra. Dhe kuptohet në dispozitat përfundimtare neni 52 e përmendën e dhe parafolsit dhe e përkrahi hapt që e shtruan ata. Ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit,

Z. Bajrush Xhemajli,

Të nderuar të pranishëm, të nderuar ministra, Komisioni për tregti dhe industri i këtij Parlamenti ka pasur si prioritet këtë ligj për nxjerrjen e tij ligji kemi menduar se është shumë i rëndësishëm dhe mu për këtë kemi pas një pikë të rendit të punës në një nga mbledhjet tona , ku e kemi thirrur edhe këshilltarin e ministrit dhe jami munduar të japim sygjerimet tona para se të dal ky ligj dhe mund të them se kemi dhënë një kontribut modest në këtë drejtim, mendoj se ky ligj duhet përkrahur në parim, në përgjithësi siq është pasi konsideroj se është në nivel të kënaqshëm , natyrisht që ka të metat e veta por regullon aspektin e tregtisë me jashtë dhe çka është më e rëndësishme se është në përputhshmëri me standardet e OBT-së dhe standardet e këshillit evropian dhe kompatibil me ta , gjë që mundëson liberalizimin e tregtisë së Kosovës me vendet në

rajon dhe më gjërë e në perspektiv hap shtigje të reja që të integrohet me ato vende edhe më tepër kjo reflektohet përgjithësisht në ekonominë e Kosovës, pozitivisht dhe mendoj që gjithsesi duhet përkrahur, unë mendoj se janë dhanë disa vërejtje substanciale dhe komisioni për tregti dhe industri që udhëheq, që të ketë parasysh por edhe ne do t mundohemi që si komision të japim kontributin tonë dhe besoj se këtë do ta bëjmë se shpejti në një mbledhje tonën dhe pastaj në shqyrtimin e dytë natyrisht që do të mundohemi ta japim verzionin e fundit, m ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit, Alush Gashi, dhe le të përgaditet Fatmir Sejdiu.

Z. Alush Gashi,

I nderuari kryetar, të nderuar deputet, duke lavdëruar punën e Qeverisë në përgaditjen e këtij drafti më lejoni të shprehim një prej vërejtjeve të mija substanciale në këtë ligj, mendoj se këtu mungon një kaptin e posaçme, kaptin e cila do të mundësonte themelimin e zonave të lira doganore në Kosovë, Kosova siç e dini ballafaqohet me një papunësi më të madhe në rajon dhe mendoj se themelimi i zonave të lira doganore do të jetë një prej arsyeve të ardhjes së investitorëve të huaj me hapjen e vendeve të reja të punës dhe prodhimeve dhe ato prodhime pastaj do t eksportoheshin nga Kosova dhe do të begadonte tregtin me jasht, e japi këtë sygjërim respektivisht propozim timin që grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por mendoj se edhe grupet tjera do ta mbështesin këtë dhe do ta paraqesin si amandament të posaqëm, them edhe grupet tdjera parlamentare se në bised me deputet egziston një vetëdije shumë e lartë për nevojën dhe hapjeve të vendeve të reja të punës dhe kjo kish me qen mendoj një prej mënyrave më të mira eventualisht edhe më të shpejta për intensifikim të kësaj tregtije, aq më tepër kur në Kosova të gjitha ligjet që miratohen punohen sipas standardeve të unionit evropian, aq më tepër kur me 18 qershor këshillit i ministrave në Luksemburg është trajtu çështja që produktet nga Kosova të jenë të liruara nga dogana, kjo e ngritë urgjencën e miratimit të një ligji për doganën, mendoj që do të jetë pak vështirë ky ligj të jetë efektiv pa e pas një sistem doganor kompatibil me kohën në të cilën jetojmë, ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit, Fatmir Sejdiu

Z. Fatmir Sejdiu,

Falënderit z. Kryetar. Të nderuar deputet. Besoj se këlthij projektligji ju dha mbështetje parimore dhe kujtoj se është e qëndrueshme nuk do të flas më gjatë për shkak të synimeve që ka dhe që është një fushë tepër e nevojshme për Kosovën. Për veprimin e institucioneve të saj dhe nuk dua të ndalem në ndonjë vërejtje, nga një shiqim tjetër mund të shihet ndryshe dhe pikërisht ne do të kemi një shans të mirë sikur kësaj radhe që në fazën përgaditore të shqyrtimit të dytë secili nga deputetët ndaj atë që me grupet paramentare të bashkangjiten në tërsi themi të asaj që mendojmë se duhet të jetë pjesë e begatimit të këlthij ligji, unë do të thosha vetëm një pjesë të një vërejtje

parimore eventualisht që ka të bëjë ndoshta edhe me pjesën e teknikës të miratimit të ligjit e sidomos kur është fjala për definicionet çështja e sqarimeve që janë nuk janë pjesë e normës. Pjesa fillestare që lidh me synimet edhe këtu apsolutisht është pjesë e normës , kjo pjesë duhet të jetë pjesë e inkorporuar në ta quajmë fazë fillestare në pjesën hyrëse të ligjit eventualisht mund të shkojë edhe në fazën, në pjesën e fundit , fillimisht mund të shkojë kësisoji, nuk është pjesë norme, këtë duhet ta kenë parasysh përfaqësues të Qeverisë dhe të tjera , kaq ju falënderit.

Kryetari Daci, ju falënderit , më lejoni që të konstatoj sa vijon, desha ta përfundoj po,
G-dja. Rada Trajković,

Poštovani predstavjuči , poštovane kolege poslanici , ja imam samo jednu želju u stvari da je ovo prvo čitanje ovoga zakona a da koalicija povratak zaista želi da u svemu učestvuje za dobrobit svih stanovnika na prostoru Kosova i Metohije , želim da vas zamolim, zve zakone koje usfajamo bubu u stavri u funkciji onoga što jeste naš mandat to je u funkciji Rezolucije 1244 i poštovanja ustavnog okvira , da ne bi imali neprijatnih dešavanja u smislu napuštanja poslanika koaliciona povratak kod usvajanja zakona zaista ja bih molila da svi funkcionisemo u tom smeru, i da još jedan put potcetim da zakoni koji su u funkciji odvajanja ovog prostora od Srbije i Jugosllavije zaista biće zakoni na koji će koaliciona povratak ne samo da neće učestvovati u njihovu izgradu , nego da će i nažalost mora biti prinudena da napusti parlament, kažem još jedan put podsećam da želim izvršena zakonodavna vlast vrati svom mandau koji ima i onda zaista svi da radimo za ono zašto smo prihvatili samim izlaskom na izbore da čemo raditi, hvala.

Kryetari Daci, unë do ti lutja deputetë do ta merrni të gjithë fjalën nuk ka përkufizime, mos të katalizohen nga debatet në zhvillim e sipër ata që e kanë analizuar ligjin , ata që kanë propozime që e ndihmojnë, ishte një debat i shkëlqyer deri më tani, kryesisht profesional, urdhëro z. Deputet Hajdari. Mos të ngjitemi në asnjë fjalë të ndonjë deputeti.

Z.Tomë Hajdaraj,

Z. kryetar, deputet të nderuar, unë nuk do të merrem me çështje mitologjike, por duke ju bashkangjitur diskutimeve të parafolësve të mi dhe punës që ka bërë inistria për tregti rreth ligjit për tregti të jashtme , unë mendoj që në pjesën e dytë të kërkesave të standardeve teknike për mallrat e importuara , neni 12 ku janë të definuara kushtet sanitare dhe fitosanitare mendoj profesor se asht me rëndësi të ceket edhe kapitullit i veçantë për import dhe eksport të mallrave me origjin animale të cilat për fat të keq ne i prodhojmë shumë pak dhe importojmë shumë, shumë, dhashtë zoti që në të ardhmen ne të eksportojmë më shumë dhe importojmë vetëm ato që nuk prodhohet në Kosovë sepse rëndësia e ushqimit të shëndoshë drejtëpërdrejtë ka ndikim në familjen e shëndoshë dhe unë mendoj që Kosova ka nevojë për familje të shëndoshë dhe për politikë të shëndoshë, ndërsa sa i përket pjesëve a do të hiqen a sdo të hiqen apo statusin

e ingjencat e obligimeve që ka ky Kuvend mendoj që hap pas hapi po shkojmë drejt asaj që jemi përcaktuar të gjithë, bile bile mos të them me referendumin e para disa viteve, ju falënderit,

Deputeti Isuf Sutaj, urdhëroni

I nderuari kryetar dhe të nderuar deputet, une dola me të vetmin qëllim që tju përkujtoj disa masa rrestriktive të cilat nuk janë përmend në këtë ligj por njëkohësisht e bëj pyetjen , a duhet të jenë në këtë ligj, unë do ti quaja masa të larta të restriksionit të cilat shtetet ndaj shteteve mund ti përdorin ekëto janë: masat e proteksionizmit, sanksionet dhe embargo, do të thotë se si do të silllet Kosova ndaj këtyre tri elementeve, që unë kushtimisht po i quaj si massa të larta të restriksionit, sa i përket masave të proteksionizmit ju garantoj me kokë se ato aplikohen ndaj Kosovës , jo në mënyrë të hapt por fshehurazi, se mallrat e Kosovës shumë pak depërtojnë jasht, kurse Kosova është mbush me qdo lloj malli, ju falënderit.

Kryetari Daci, e besoj që debati në parim është rrumbullaksuar është një debat ndoshta për herë të parë i shkëlqyer, kryesisht i motivuar në profesion, në avansime të ligjit, prandaj e shtroj në votë formale shqyrtimin e parë në parim të Ligjit për tregtinë e jashtme , kush është për aprovim në parim , numroni votat ju lutem , pyes deputetët se a është kush kundër aprovimit në parim të këtij ligji, 1 deputet ju falënderit, a ka abstenuar dikush, a do të abstenoj dikush, numroni ju lutem,

Rezultatet e votimit janë: 67 deputet kan votuar pro, aprovimit të këtij ligji , vetëm 1 deputet është kundër, kan abstenuar 15 deputet, prandaj konsideroj se mund të shkoj ti dërgohet komisioneve përkatëse atij të për tregti dhe ekonomi, dhe të komisioneve tjera të domosdoshme, dhe i kam dy informacione, asnjë pyetje e deputetëve nuk është parashtruar konform rregullores, d.m.th me shkrim , dhe informata e dytë ka të bëjë me ate që Kryesia në parim ka aprovuar një plan të punës të Kuvendit të Kosovës në seanca plenare të kryesisë dhe të komisioneve që ne do ti plmbahemi ati plani, varet nga dërgimi i inuteve në Parlament, Parlamennti nuk do të vonoj asnjë propozim dhe asnjë procedurë, ju falënderit për pjesëmarrje.

Mbledhja e ardhshme është me 17 tetor 2002.